

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EURO FRUITS” Sh.p.k.

Sot, më date **17.02.2025**, ne te nënshkruarit:

- **Z.Barjam Halla** lindur me 04/11/1991, shtetas shqiptar, banues ne Lushnje, identifikuar me nr. personl J11104081H, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.-**Z. Emiljan Buzi**, shtetas shqiptar, i datlindjes 15.04.1984, banues ne Lushnje, identifikuar me nr. Personal I40415208O, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.-**Z. Jashar Buzi**, shtetas shqiptar, i datlindjes 08.05.1992, banues ne Lushnje, identifikuar me nr. Personal J20508120R, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“EURO FRUITS” Sh.p.k.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: **“EURO FRUITS” Sh.p.k**

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : Lushnje Karbunare e Poshtme Rruga Lushnje-Fier Km 2 Nr.pasurie 834/16, zk 8571.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: barjamhalla@gmail.com
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- Grumbullim dhe eksportim te fruta perimeve, etj.
- Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtojte dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar



(1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **5 000 000** (Pese million) leke. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Barjam Halla**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **1 650 000** leke që përbën **33 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 2. Ortaku themelues **Emiljan Buzi**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **1 650 000** leke që përbën **33 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 3. Ortaku themelues **Jashar Buzi**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **1 700 000** leke që përbën **34 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asambleja e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortakët janë te detyruar qe ta repektojnë dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asmblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfundimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen ne statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

Aministratori i shoqërisë emërohet **Z.Barjam Halla** lindur me 04/11/1991,shtetas shqiptar,banues ne Lushnje, identifikuar me nr. personl J11104081H,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar. i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxirjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara ne statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKET E SHOQERISE

Barjam Halla



Emiljan Buzi



Jashar Buzi

